

URDHËR
Nr.500, datë 7.10.2011

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË TË DOKTORATËS, NË
UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR XHUVANI” TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimeve të Doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe përcaktimin e kushteve, që duhet të plotësojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen në universitetin “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit, të programeve të studimeve të ciklit të tretë, të Doktoratës, si vijon:

a) Doktoratë në “Albanologji” në profilin “Histori”, në Fakultetin e Shkencave Humane, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr) në “Albanologji” në profilin “Histori”.

b) Doktoratë në “Albanologji” në profilin “Gjuhësi”, në Fakultetin e Shkencave Humane, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr) në “Albanologji” në profilin “Gjuhësi”.

2. Programet e studimit të ciklit të tretë, të Doktoratës, zgjasin të paktën 3 vite akademike dhe përfshijnë 60 kredite për studime të organizuara teorike.

3. Programet e studimit të fillojnë në vitin akademik 2011-2012.

4. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, pa efekte buxhetore shtesë.

5. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe universiteti “Aleksandër Xhuvani” i Elbasanit, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj